

**SBASHK****Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures**

Arsimimi

KULTURA E NJERIUT*Ë-buletin**Qershor, 2021*

SBASHK vazhdon me një aktivitet që është bërë tradicional **Qindra anëtarë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar**



Është nisur para disa vitesh dhe tani më është kthyer në aktivitet tradicional dërgimi i qindra anëtarëve për pushime në bregdetin shqiptar. Ky aktivitet sivjet po zhvillohet me entuziazëm nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafi qendror sepse ata kështu po shprehin respekt për angazhimin dhe përkushtimin e punëtorëve arsimor në këtë vit mësimor plot sfida e vështirësi të krijuara nga pandemia. Koordinatori Ymeri tregon se përgatitjet kanë nisur me kohë dhe bashkë me stafin ...(faqe 4)

Takime të shpeshta me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Në krye të angazhimeve në situatat plot sfida



Situata aktuale në arsim, sfidat e vështirësitë e shumta të krijuara ...(faqe 5)

Një takim jo i lehtë në MASHTI

Mbrojtje me argumente e qëndrimeve të SBASHK-ut



Pas disa përplasjeve e kundërshtimeve ...(faqe 9)

Intervistë me aktoren dhe sindikalisten Elida Shasivari Dula

Një jetë në skenë dhe në shërbim të artit dhe fjalës së shkruar



Elida një jetë në skenë. E dashur për ...(faqe 3)

Vazhduan të mbahen Kuvendet zgjedhore nëpër komunat e Kosovës

Atmosferë përkushtimi në Ferizaj, Lipjan e në Skenderaj



Në kohën kur procesi zgjedhor nëpër shoqata ...(faqe 6)



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës
The Union of Education, Science and Culture

Editorial

Në përmbyllje të një viti të vështirë mësimor



Qershori shënon përmbylljen edhe të një viti mësimor. Ishte ky një vit i vështirë e plotë sfida. Pandemia krijoi vështirësi të mëdha, të cilat u përballuan falë angazhimit maksimal të punëtorëve arsimor dhe mbështetjes së vazhdueshme të SBASHK-ut për ta. Ishin zotuar punëtorët arsimor se do të japin gjithë kontributin që mësimi të zhvillohej në institucione arsimore dhe e mbajtën fjalën edhe pse u përballën me sfida dhe me rrezikun që u qëndronte mbi kokë nga prekja me Covid. Ishte angazhim i pa ndërprerë i mësimdhënësve në misionin e tyre të shenjtë dhe tani po analizohen arritjet. E dimë se

do të ketë edhe të atillë që do të llafojnë sa për të thënë diçka, e do të mundohen të ulin këto arritje, por e kanë të kotë. Punëtorët arsimor dhanë gjithë kontributin dhe arritjet janë më të mëdhatë të mundshme.

SBASHK-u në shenjë respekti për gjithë angazhimin e përkushtimin e brenda mundësive buxhetore vazhdoi me traditën e mirë duke dërguar për pushime në bregdetin shqiptar një numër të konsideruar të këtyre njerëzve të sakrificës. Ata duke pushuar ndjehen krenar me sindikatën e tyre dhe shpalosin kujtime duke rikthyer kujtesën për momente plot stres gjatë gjithë këtij viti mësimor. Ata flasin edhe për shtatorin që po vije dhe urojnë që të fillohet mbarë e pa Covid e vështirësi të tjera. Urojnë edhe që të ketë dialog të suksesshëm me institucionet në mënyrë që të mos ketë nevojë për veprime sindikale, por as ato nuk i përjashtojnë. Ata do të veprojnë si gjithmonë unik dhe bashkë e në SBASHK.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK) përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel. +383(0)38/ 226 940



Intervista

Intervistë me aktoren dhe sindikalisten Elida Shasivari Dula

Një jetë në skenë dhe në shërbim të artit dhe fjalës së shkruar



Elida një jetë në skenë. E dashur për publikun. Përveç aktrimit, hobi e ka edhe rrobaqepësinë, grimin, pikturën, shkrimin e teksteve humoristike

satirike. Organizatore e festivalit të komedisë në Gjakovë. Po ashtu ka botuar bashkë me profesor Muhamet Rogova veprën "Kujtime në pritje të Nënë Ferdonijes". Është anëtare e SBASHK-ut e gatshme për të dhënë kontribut edhe në aktivitetet sindikale në shërbim të kolegëve të saj nga sektori i kulturës. Një intervistë të shkurtër me Elidën po sjellim në këtë numër të gazetës sonë.

Arsimimi sot:

Kush është Elida Shasivari Dula ?

Elida:

Aktore prej vitit 1982 pranë teatrit të qytetit "Hadi Shehu" në Gjakovë. Nënë e dy fëmijëve. E lindur, e rritur dhe jeton ende në Gjakovë. Krahas profesionit merret edhe me aktivitete me gra, incizime të skenarëve të ndryshëm të filmit, bashkëpunon me të gjitha radio-televizionet e radiot e Kosovës. Ende jam aktive në programe e prezantime të ndryshme televizive dhe në skenën e teatrit. Jam edhe anëtare e SBASHK-ut. Para luftës njëra nga themelueset e shoqatës bamirëse "Nënë Tereza" në Gjakovë. Pas luftës prapë kam themeluar një shoqatë humanitare "Ne për Ju" mirëpo për shkaqe teknike më është dashur të mbyll shoqatën. Si e re valltare pranë Shoqërisë kulturore "Hajdar Dushi" në Gjakovë. Anëtare e klubit letrar "Gjon Nikollë Kazazi". E përveç aktrimit, hobi e kam edhe rrobaqepësinë, grimin, pikturën, shkrimin e teksteve humoristike satirike. Organizatore e festivalit të komedisë në Gjakovë që vitin e parë ka qenë festival kombëtar, pastaj vitin e dytë jemi bërë edhe pjesë e festivalit ndërkombëtar. Gjithashtu kam botuar

librin bashkë me profesor Muhamet Rogova për Nënë Ferdonijen. Libri titullohet "Kujtime në pritje të Nënë Ferdonijes". Pandemia për të gjithë njëjtë. Një nënë e përkushtuar dhe një amvise e mirë.

Arsimimi sot:

Çfarë duhet të bëj më shumë sindikata për sektorin e kulturës?

Elida:

Sa i përket sektorit të kulturës, duke iu falënderuar sindikatës ne kërkojmë nga institucionet të na krijohen kushte më të mira të punës dhe të bëhet nivelizimi i pagave.

Arsimimi sot:

Si ndjeheni si anëtare e SBASHK-ut?

Elida:

Unë edhe më parë kam qenë sindikaliste. Njëherë kam qenë edhe kryetare e sindikatës në nivel të teatrit të Gjakovës në vitin 1987. Është kënaqësi të jesh pjesë e kësaj sindikate. Unë sindikatën e shoh si urë lidhëse mes institucionit dhe ministrisë së kulturës dhe qeverisë.

Arsimimi sot:

Roli i femrës në skenë dhe në sindikatë

Elida:

Aktrimi është profesion i shenjtë e mjaft i vështirë, por secili ai apo ajo e ka vështirë te ndahet nga skena. Shpërblimi i vetëm për aktorët janë duartrokitjet e publikut dhe respekti i tyre ndaj nesh. Ndërsa sindikata duhet të jemi zë i fuqishëm në realizimin e kërkesave tona.

Arsimimi sot:

Cilin aktivitet i propozoni SBASHK-ut për të ardhmen?

Elida:

Aktivitete ka mjaft, por priten aktivitete edhe më të shumta e sidomos për sektorin e kulturës. Urojmë të jenë këto aktivitete të mbështetura edhe nga Ministria.

Arsimimi sot:

A dallon Elida në skenë nga ajo e jetës së përditshme?

Elida:

Normalisht. Në jetën e përditshme jam një grua, një nënë dhe një njeri normal si gjithë njerëzit tjerë, ndërsa skena është aty ku unë duhet të performoj role të ndryshme të cilat caktohen nga regjisori.

Arsimimi sot:

Çfarë mendoni për sindikatën sot?

Elida:

Edhe pse jemi kyçur vonë si teatër në sindikatë, janë përshtypjet fantastike rreth organizimit të punëve, të aktiviteteve, të kërkesave të punëtorëve, komunikimi korrekt me kryetarët e sidomos këto ditë një përshtypje të jashtëzakonshme dhe një falënderim të veçantë për organizatorët e këtij aktiviteti tradicional në bregdetin shqiptar. Pushim i shkurtër ky, por një udhëtim dhe një pushim që do të mbetet gjatë në kujtesën e secilit që ishte prezent në këtë organizim sindikal.

Gjatë muajit

SBASHK vazhdon me një aktivitet që është bërë tradicional

Qindra anëtarë nga e tërë Kosova në bregdetin shqiptar

Është nisur para disa vitesh dhe tani më është kthyer në aktivitet tradicional dërgimi i qindra anëtarëve për pushime në bregdetin shqiptar. Ky aktivitet sivjet po zhvillohet me entuziazëm nga koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri dhe stafi qendror sepse ata kështu po shprehin respekt për angazhimin dhe përkushtimin e punëtorëve arsimor në këtë vit mësimor plot sfida e vështirësi të krijuara nga pandemia. Koordinatori Ymeri tregon se përgatitjet kanë nisur me kohë dhe bashkë me stafin qendror janë angazhuar edhe kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve, të cilët janë përkujdesur që të respektohen në tërësi kriteret e përcaktuara nga organet drejtuese të SBASHK. Ai tregon se duke u nisur në këto kritere këtë vit në bregdetin shqiptar SBASHK dërgon 452 pushues nga e tërë Kosova, që janë përzgjedhur nga shoqatat sindikale të arsimit, shkencës dhe kulturës.



Koordinatori për organizim të brendshëm në SBASHK sqaron se kjo traditë e mirë këtë vit ka nisur më 20 qershor me grupin e parë të pushuesve prej 78

anëtarëve për të vazhduar edhe me dy grupe të tjera, njëri më 245 pushues dhe tjetri më 129 të tjerë, që do të pushojnë nga 27 qershori, gjegjësisht nga 4 korriku duke e përmbyllur këtë aktivitet që shpresohet të ketë rrjedhë të mbarë.



Pushimi i grupit të parë kishte rrjedhë të mbarë dhe shumë nga pushuesit kanë lënë përshtypjet e tyre të shkruara, të cilat do të ruhen me kujdes e një pjesë e tyre edhe do të botohen në njërin nga numrat e radhës së gazetës sonë. Po ashtu atmosferë e këndshme e shoqëruar me bashkëbiseda e humor të lehtë është edhe mes pushuesve të grupit të dytë. Ata janë shumë mirënjohës ndaj SBASHK-ut. Momente plot emocione janë ato nga bashkëbisedat e shumë pushuesve me kryetarin e SBASHK-ut. Ata bëjnë edhe foto për kujtim nga këto momente të paharruara të pushimit në bregdetin shqiptar. Rrjedhës së mbarë të këtij aktiviteti tradicional po i kontribuojnë edhe Albina e Blendori bashkë me kujdestarët tjerë, që janë në krye të

angazhimeve dhe kujdesën që çdo gjë të ketë rrjedhë të mbarë.



Edhe kësaj radhe ka nga ata që e thonë se kjo është hera e parë që ata po shoqërohen me valët e qeta të detit dhe me një atmosferë kaq mbresëlënëse të Kompleksit hotelier, që krijohet nga kushtet e vendosjes dhe nga mikpritja e gjithë personelit këtu. Të gjithë po deklarohen se ditët e pushimit po ikin shpejt dhe janë të bindur se do të kthehen me përshtypje të shkëlqyera në vendlindjet e tyre. Koordinatori për organizim të brendshëm uron që atmosferë e tillë të mbretërojë edhe në ditët e pushimit të grupit të tretë nga 4 korriku.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri kanë organizuar takime të ndara me pushuesit

për t'i përshëndetur e për t'i përgëzuar për angazhimet në shërbim të arsimit e edukimit të brezave. "Ju keni dhënë kontribut të lartë nëpër vite e dekada në shërbim të arsimit e edukimit të brezave dhe jam krenar me unitetin dhe përkushtimin që keni dëshmuar në gjithë aktivitetet sindikale. E di se edhe në këët aktivitet ju do ta ruani figurën e nderuar të mësuesit nga Kosova. Respekt Astritit dhe gjithë stafit për mikpritjen. Falënderoj për angazhimin maksimal që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë Ymerin, Blendorin, Afërditën, Albinën, Vlorën, Basriun, Ramizin, Avdullahun, Hakiun. Në gëzime u takofshim gjithmonë", është shprehur kryetari Jasharaj në fjalën përshëndetëse drejtuar pushuesve.



Takime të shpeshta me kryetarët e nivelit komunal dhe të Universiteteve

Në krye të angazhimeve në situatat plot sfida



Situata aktuale në arsim, sfidat e vështirësitë e shumta të krijuara nga pandemia, përkushtimi për të realizuar gjithë kërkesat legjitime e të arsyeshme të anëtarësisë dhe qëllimi i drejtë për koordinimin e gjithë aktiviteteve sindikale ka bërë që të mbahen

takime të shpeshta konsultative me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve. Kështu ishte edhe në takimin e radhës në të cilin janë konkretizuar edhe çështjet që u bisedua në takimin me Ministren e MASHTI-t, Arbërie Nagavci.

Edhe në këtë takim fillimisht është bërë një analizë e rrjedhës së aktivitetit të zgjedhjeve të brendshme në SBASHK dhe për këtë kanë treguar kryetarët e nivelit komunal sindikal duke u shprehur se zgjedhjet në shoqata po zhvillohen duke respektuar Statutin dhe vendimet e organeve të SBASHK-ut dhe se ky proces do të përfundojë me kohë për të vazhduar pastaj në njësitë akademike dhe më vonë e sipas

agjendës edhe në Kuvendet e niveleve arsimore duke u përgatitur kështu edhe për Kongresin e radhës.



Është zhvilluar pastaj debat në formë bashkëbisede edhe për rrjedhën e trajnimeve dhe është vlerësuar i përbashkët se janë shënuar rezultate të larta falë angazhimit të koordinatorit për organizim të brendshëm, stafit qendror, trajnerëve, kryetarëve të nivelit komunal sindikal dhe të pjesëmarrësve në këtë aktivitet. U arrit marrëveshja që ky aktivitet të reduktohet ngase janë shumë aktivitete të lidhura me kohë dhe se ky aktivitet do të rinis me gjithë

Vazhduan të mbahen Kuvendet zgjedhore nëpër komunat e Kosovës

Atmosferë përkushtimi në Ferizaj, Lipjan e në Skenderaj

Në kohën kur procesi zgjedhor nëpër shoqata sindikale kudo në Kosovë është në përfundim e sipër dhe është realizuar duke respektuar në përpikëri Statuti i SBASHK, kanë nisur të mbahen edhe Kuvendet zgjedhore në disa prej komunave. Kështu në realizim të kësaj agjende janë mbajtur edhe Kuvendet zgjedhore në Ferizaj, Lipjan e Skenderaj.

Në një atmosferë pune e përkushtimi është mbajtur Kuvendi zgjedhor në Ferizaj. Në hapje të këtij takimi kryetari i këtij Kuvendi ka përshëndetur kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, koordinatoren për organizim të brendshëm Ymer Ymeri duke shprehur respekt të lartë për përkushtimin dhe angazhimin e tyre në shërbim të realizimit të kërkesave të anëtarësisë. Sadiku pastaj ka nisur të shpalos pikat e rendit të punës duke prezantuar fillimisht raportin e punës për katër vitet e kaluara e pastaj edhe atë financiar. Pjesëmarrësit e këtij Kuvendi i kanë vlerësuar si të plotë e përmbajtjesorë këta dy raporte dhe i kanë aprovuar njëzëri. Duke falënderuar

kapacitetet e mundshme në fillim të vitit të ri shkollor. Në këtë takim konsultativ pjesëmarrësit janë zotuar se do të dorëzojnë në kohën më të shpejt të mundshme edhe deklarimet e anëtarësisë sonë që autorizojnë përfaqësimin në gjykatë lidhur me kërkesën që të realizohet Vendimi i Qeverisë për mbështetje prej 100 euro për punëtorët arsimor për shkak të rrezikut permanent nga Covid dhe për arsye të shtimit të volumit të angazhimeve në procesin mësimor.



Kryetarët kanë dhënë kontribut me vlerë edhe lidhur me çështjet që do të debatohen nga kryetari dhe përfaqësuesit e tjerë të SBASHK-ut në takimin me Ministren Nagavci dhe përfaqësues të Kabinetit të saj.

pjesëmarrësit për diskutimet e frytshme Sadiku është shprehur se me unitet e përkushtim jemi angazhuar dhe kemi arritur rezultate të shumta në realizimin e kërkesave të anëtarësisë falë koordinimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me stafin qendror dhe kontributit të përfaqësuese tanë në organet gjegjëse të SBASHK-ut në nivelin komunal dhe atë qendror”.



Kryetari i SBASHK-ut ka shprehur respekt meritore për gjithë anëtarët e SBASHK-ut nga kjo komunë duke i falënderuar për angazhimin dhe

unitetin. Ai ka falënderuar kryetarin Sadiku për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë.



“Ndjem krenar që kam pasur nderin të angazhohem në shumë aktivitete bashkë me Rexhën. Ai në momentet më sfiduese gjente fjalë inkurajimi dhe krijonte atmosferë zelli e përkushtimi”, ka deklaruar kryetari Jasharaj duke u shprehur i sigurt se me unitetin që përkushtimin që ka SBASHK në Ferizaj dhe tërë Kosovën çdo sfidë do të kalohet suksesshëm dhe do të shënohen arritje edhe në të ardhmen në shërbim të anëtarësisë. Para se të kalohej në procesin zgjedhor disa nga pjesëmarrësit kanë bërë pyetje lidhur me aktivitetin dhe çështjet sindikale në të cilat është përgjigjur koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. Ai ka dhënë sqarime edhe lidhur me procesin zgjedhor, i cili ka nisur për të zgjedhur kryetarin, nënkryetarin, anëtarët e kryesisë, delegatët nga Ferizaj për Kongresin e SBASHK-ut dhe përfaqësuesit për Këshillin Drejtues. Me votën e fshehtë e të lirë ky Kuvend ka zgjedhur për kryetarë Fejzullah Vranovcin, kurse për nënkryetar Arben

Hysenin. Po ashtu me votë të fshehtë e të lirë janë zgjedhur edhe anëtarët e kryesisë, përfaqësuesit për Ferizajn në Këshillin Drejtues dhe delegatët për Kongresin e SBASHK-ut. Duke shprehur respekt për punën, angazhimin dhe përfaqësimin me sukses të kërkesave të anëtarësisë, ky Kuvend ka kandiduar edhe për një mandat Rrahman Jasharajn për kryetar të SBASHK-ut. Kryetari Jasharaj është shprehur i nderuar dhe krenar për këtë mbështetje duke premtuar se do të vazhdojë me angazhimet dhe bashkë me stafin qendror do të punojë e angazhohet pa u ndalur për ta ruajtur besimin që anëtarësia ka për ta. Në mbyllje të këtij takimi zgjedhor kryetari i zgjedhur Vranovci ka falënderuar Kuvendin për besimin e dhënë dhe është shprehur se do të vazhdojë rrugëtimin e angazhimit duke qenë i sigurt se edhe në të ardhmen do ta ketë mbështetjen e gjithë anëtarësisë dhe do të komunikojë në vazhdimësi me ish kryetarin Sadiku dhe me stafin qendror e me kolegët e tij nga e tërë Kosova. Ai duke shprehur respekt të lart për angazhimin nëpër vite të Rexhep Sadikut e ka propozuar atë për kryetar nderi, propozim të cilin me duartrokitje e kanë aprovuar gjithë të pranishmit.

Agjenda e realizimit të Kuvendeve zgjedhore ka vazhduar të mërkurën e 16 qershorit në Lipjan. Kryetari i këtij Kuvendi, Emrush Ahmeti ka prezantuar para pjesëmarrësve një raport të detajuar të angazhimeve. Ishte ky moment i mirë që të bëhet analizë e angazhimeve, sfidave dhe arritjeve të kryetarit, kryesisë dhe Kuvendit të sindikatës së Arsimit Parauniversitar në këtë komunë dhe në nivelin qendror. Ky raport është aprovuar dhe është vlerësuar lart nga pjesëmarrësit. Kryetari Ahmeti ka prezantuar edhe raportin financiar duke e ndarë nëpër vite, i cili po ashtu është aprovuar nga pjesëmarrësit e këtij Kuvendi. Ai pastaj ka përshëndetur në emër të gjithë sindikalistëve të arsimit të Lipjanit kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe koordinatori për organizim të brendshëm Ymer Ymeri. “Ndjem krenar që kam pasur nderin të punoj në shërbim të anëtarësisë me kryetarin Emrush Ahmeti, i cili prezantuar në mënyrë të denjë shqetësimet dhe kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut nga kjo komunë dhe ka dhënë kontribut të çmuar në realizimin e këtyre kërkesave”, është shprehur Jasharaj në fjalën e tij përshëndetëse, kurse koordinatori për organizim të

brendshëm Ymer Ymeri është përgjigjur në pyetjet e pjesëmarrësve dhe ka dhënë sqarime lidhur me rrjedhën e procesit zgjedhor dhe rregullat konkrete që janë të sqaruara në Statutin e SBASHK-ut. Pas kësaj është kaluar në procesin zgjedhor. Në garën mes dy e më shumë kandidatëve e përmes votës së fshehtë është zgjedhur kryetari, nënkryetarja, kryesia, Komisioni mbikëqyrës, delegatët për Kongresin dhe përfaqësuesit nga Lipjani në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut. Pjesëmarrësit duke shprehur respektin meritore për punë dhe angazhimin e Emrush Ahmetit e kanë zgjedhur atë për kryetar edhe për mandatin e ardhshëm katër vjeçar. Nënkryetare, po ashtu përmes votës së fshehtë, është zgjedhur Valbona Kryeziu.



Duke vlerësuar angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit Jasharaj pjesëmarrësit e këtij Kuvendi kanë shprehur idenë që ai të propozohet në këtë detyrë edhe në mandatin e radhës. Kryetari i SBASHK-ut është shprehur se vlerëson lart këtë respekt dhe besimin e kolegëve nga Lipjani dhe se do të vazhdojë me angazhimet për të arsyetuar besimin e anëtarësisë.

Kuvend zgjedhor edhe në Skenderaj

Agjenda e takimeve zgjedhore ka vazhduar edhe të enjten e 17 qershorit në Skenderaj. Para këtij takimi kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj, nënkryetarja Vjollca Shala dhe kryetari i Kuvendit të sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Skenderajn Ramiz Polaci janë takuar me Drejtorin e DKA-së për këtë komunë

Blerim Latifi. Ata kanë bashkëbiseduar për situatën aktuale në arsim dhe për bashkëpunimin dhe arritjet e përbashkëta në realizimin e kërkesave të punëtorëve arsimor në këtë komunë. Drejtori Latifi ka zhvilluar një bashkëbisedë edhe me pjesëmarrësit në Kuvendin zgjedhor duke u përgjigjur në pyetjet e tyre. Ai ka vlerësuar lart angazhimin dhe përkushtimin e kryetarit të SBASHK-ut, të stafit qendror dhe të kryetarit të sindikatës së nivelit komunal Polaci. Pas këtij takimi përmbajtjesor kryetari Polaci bashkë me përfaqësuesit e SBASHK-ut janë gjendur mes pjesëmarrësve të Kuvendit zgjedhor. Në hapje të këtij takimi kryetari i këtij Kuvendi Ramiz Polaci ka përshëndetur kryetarin dhe nënkryetaren e SBASHK-ut duke i përgëzuar në merr të gjithë anëtarësisë në Skenderaj për angazhimet e përkushtimin e pastaj ka nisur të shpalos pikat e rendit të punës duke prezantuar fillimisht raportin e punës për aktivitetin 4 vjeçar sindikal dhe raportin financiar.

Këto dy raporte janë aprovuar nga pjesëmarrësit e pastaj është kaluar në procesin zgjedhor. Nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala ka dhënë sqarime lidhur me rregullat që duhet respektuar gjatë gjithë procesit zgjedhor. Me votën e lirë e të fshehtë janë zgjedhur organet udhëheqëse të këtij Kuvendi, Komisioni mbikëqyrës, delegatët e Kongresit dhe përfaqësuesit e Skenderajt në Këshillin Drejtues të SBASHK-ut.

Duke e vlerësuar angazhimin dhe përkushtimin e tij Kuvendi ka rizgjedhur Ramiz Polacin kryetar edhe për një mandat, ndërsa nënkryetare është zgjedhur Flaureta Neziri. Janë zgjedhur edhe tre anëtarë të Komisionit mbikëqyrës, tre delegatë për Kongresin e SBASHK-ut dhe dy përfaqësues nga Skenderaj për këshillin Drejtues.

Në mbyllje të këtij Kuvendi zgjedhor Polaci është falënderuar për besimin e dhënë dhe ka premtuar vazhdimin e angazhimeve bashkë me kryesinë në shërbim të anëtarësisë. Ai i ka propozuar Kuvendit që duke u nisur nga fakti se kryetari Jasharaj ka prezantuar në mënyrë të denjë bashkë me gjithë stafin qendror të SBASHK-ut kërkesat e anëtarësisë të kandidohet nga ky Kuvend për kryetar edhe në mandatin e radhës. Pjesëmarrësit e kanë mbështetur këtë propozim me vota unanime dhe duartrokitje.

Një takim jo i lehtë në MASHTI

Mbrojtje me argumente e qëndrimeve të SBASHK-ut



Pas disa përplasjeve e kundërshtimeve të arsyeshme të SBASHK nga larg e përmes medieve lidhur me çështje aktuale në arsim, është zhvilluar në MASHTI një takim jo i lehtë mes Ministres Nagavci dhe dy zëvendësministrave dhe kryetarit të SBASHK-ut Rrahman Jasharaj e nënkryetares Vjollca Shala. Kishte mjaft çështje që janë ngritur në këtë takim dhe përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë mbrojtur me argumente qëndrimet dhe kanë përcjellë kërkesat he zërin e anëtarësisë duke kritikuar MASHTI-n për vendime të ngutshme dhe për disa deklarata, që kishin

nxituar arsyeshëm reagimin e anëtarësisë. Të dy palët janë pajtuar se çështjet duhet zgjidhur përmes takimeve dhe përmes dialogut. Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë deklaruar se as në të kaluarën e as tani e gjithmonë nuk ka kush që mund të përçaj SBASHK-un e as ta pengojë që të angazhohet në mbrojtje të kërkesave legjitime të anëtarësisë, e cila është unike dhe i beson përfaqësuesve të saj.

Disa nga temat e hapura është vendosur të debatoheshin në takimin me DKA-të me qëllim që bashkërisht të merren vendime edhe lidhur me përfundimin e vitit mësimor për të cilën gjë MASHTI kishte përmendur datën 8 korrik, por se SBASHK-u ishte shprehur kundër e duke kërkuar që të respektohet Kalendari mësimor për këtë vit shkollor. Pas bisedave të vazhdueshme dhe në komunikim me përfaqësues të niveleve arsimore ishte arritur marrëveshje që ky vit mësimor mos të mbyllet me 8, por më 2 korrik, marrëveshje e cila u bë publike edhe në takimin me drejtorët e DKA-ve dhe me përfaqësues të SBASHK dhe të MASHTI-t.

Ministri Vitia takoi përfaqësuesit e SBASHK-ut

Bashkëbisedë për tema nga sfera e shëndetësisë

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj bashkë me nënkryetaren Vjollca Shala dhe zyrtaren Vlora Rexhepi Berisha janë takuar me Ministrin e Shëndetësisë Arben Vitia. Në këtë takim të pranishëm ishin edhe zv/ministria Dafina Gexha Bunjaku dhe koordinatorja për vaksinimin Arbëresha Nela.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj falënderoi Ministrin Vitia për përkushtimin në mënyrë që angazhimi i përbashkët që punëtorët e arsimit të jenë në prioritet të vaksinimit të realizohet dhe kështu viti i ri shkollor të na gjej me punëtorë arsimor të vaksinuar dhe të mbrojtur nga pandemia. Ky do të ishte moment i mirë dhe do të ndikonte shumë që viti i ri shkollor të ketë nismë të mbarë dhe mësimi të zhvillohet në institucione arsimore. Jasharaj iu drejtua Ministrit Vitia edhe me kërkesën e mijëra punëtorëve të arsimit që të kjo Ministri të punojë me përkushtim lidhur me funksionalizimin e Ligjit për Sigurime Shëndetësore ngase ky Ligj është tepër i nevojshëm për punëtorët arsimor, por edhe për të gjithë të punësuarit në Kosovë. Ministri Vitia ka njoftuar përfaqësuesit e SBASHK-ut lidhur me rrjedhën e procesit të vaksinimit duke theksuar se procesi po ecën sipas dinamikës së paraparë dhe se do

të vazhdohet me përkushtim në mënyrë që edhe punëtorët e arsimit të vaksinohen me kohë dhe sipas dinamikës së paraparë.

Ministri Vitia ka deklaruar se Ministria që ai drejton është e përkushtuar në angazhimet lidhur me këtë Ligj, por procedurat dhe infrastruktura

gjegjëse ligjore dhe aktet nënligjore e procedurat tjera që ndërlidhën me këtë Ligj natyrshëm kërkojnë kohë dhe hapësirë, por nuk mungojnë angazhimi dhe përkushtimi që ky Ligj të funksionalizohet kur të realizohen gjithë aktivitetet dhe procedurat gjegjëse.

SBASHK informon ETUCE-n për situatën aktuale në arsimin e Kosovës

Vit sfidues për arsimin në Kosovë dhe kudo në Evropë

SBASHK ka zhvilluar komunikim të vazhdueshëm me udhëheqës të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe me ata të Internacionales Botërore të Arsimit duke bashkëbiseduar për situatën aktuale në arsim e po ashtu përfaqësues të sindikatës sonë kanë marrë pjesë në të gjitha takimet dhe tryezat tematike të organizuara nga ETUCE dhe EI. Në shenjë të këtij bashkëpunimi SBASHK në mbarim të këtij viti shkollor ka informuar drejtoreshën e përgjithshme të ETUCE-s, Suzan Flocken lidhur me angazhimet, sfidat dhe arritjet e SBASHK-ut gjatë gjithë këtij viti arsimor.



“E nderuara znj. Flocken ju përshëndesim në

emër të gjithë anëtarësisë së SBASHK-ut dhe Ju përgëzojmë Juve dhe gjithë stafin udhëheqës të ETUCE-s për angazhimin dhe përkushtimin në përkrahje dhe mbështetje të sindikatave anëtare, përkrahje kjo që na ka dhënë forcë dhe elan shtesë për t'u përballur suksesshëm me sfidat që u krijuan nga kushtet e vështirësuara të punës dhe angazhimit nga pandemia”, thuhet në fillim të këtij komunikimi për të treguar disa nga aktivitetet në shërbim të anëtarësisë për të veçuar mbajtjen e takimeve të shumta nga larg me anëtarësinë, por edhe takime me kryetarët e nivelit komunal sindikal dhe të Universiteteve me qëllim që ta ruajmë mobilizimin e lartë në

shërbim të rrjedhës së mbarë të procesit mësimor dhe të zhvillimit të suksesshëm të aktiviteteve sindikale, pastaj monitorimin e gjendjes në institucione dhe kemi ndikuar që masat mbrojtëse nga Covid të jenë në nivel sa më të lartë. Është veçuar edhe mbajtja me sukses e shumë trajnimeve me punëtorët arsimor duke u ndihmuar të arrijnë njohuri të reja, por edhe të krijojnë përvojë të mirë në përdorimin e platformave për komunikim me nxënësit dhe prindërit në rastet kur ishin të detyruar të mbanin mësim në distancë. SBASHK në letrën drejtuar znj. Flocken dhe ETUCE-s ka kujtuar edhe arritjen në mirëkuptim me MASH-in që punëtorët arsimor me sëmundje të rënda të lirohen për këtë vit mësimor nga procesi mësimor, të marrin pagë të plotë dhe të zëvendësohen me kuadro të tjera dhe marrëveshjen me Qeverinë për një shtesë në pagë prej 100 euro për të punësuarit në sistemin arsimor për arsye të rrezikut të lartë nga Covid dhe për shkak të shtimit të dukeshim të volumit të angazhimeve që diktuan kushtet e reja të punës në sistemin arsimor. SBASHK ka kujtuar drejtoreshën e përgjithshme të ETUCE-s edhe për pjesëmarrjen në të gjitha takimet e organizuara nga institucionet lidhur me sektorin e arsimit dhe kem i mbrojtur me sukses kërkesat dhe të drejtët e të punësuarve në këtë sektor dhe për arritjen e madhe duke nënshkruar Kontratën e re Kolektive për Arsimin e Kosovës.

Përgatitjeve për trajnimet e radhës u kushtohet kujdes i veçantë

Edhe dy aktivitete të organizuara mirë

Duke vazhduar të jetë shembull i shkëlqyer i angazhimit për realizimin e kërkesave të anëtarësisë SBASHK-u ka shtuar angazhimet me qëllim të realizimit të të gjitha objektivave. Atmosferë pune e përkushtimi në stafin qendror, por edhe te kryetarët e nivelit komunal vërehet edhe në ditët e vikendit, të cilat ka kohë që janë kthyer në ditë pune e angazhimi. Kështu ishte edhe në vikendet e fundit kur në njërën anë filloi se realizuari përgatitja e trajnerëve për trajnimin e radhës “Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës, aktivitet ky që po realizohet në bashkëpunim me përfaqësuesit e ILO-s në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin mësimdhënësit kandidatë për trajnerë nga SBASHK-u të të gjitha regjioneve të Kosovës.



Në hapje të këtij aktiviteti nënkryetarja e SBASHK-ut Vjollca Shala përshëndeti pjesëmarrësit dhe i njoftoi ata për qëllimin e programit të trajnimit .Pjesëmarrës në punëtori ishin edhe kryetari I nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët të Kosovës Blerim Mehmeti dhe zyrtarja e SBASHK-ut Vlora Rexhepi Berisha.



Përfaqësuesja e ILO-s Lindita Boshtrakaj dhe Selim Mehmeti gjatë tre ditëve të punëtorisë janë angazhuar që pjesëmarrësit të fitojnë njohuri të mjaftueshme me qëllim që të jenë në nivel të detyrës së trajnerëve të ardhshëm të trajnimit "Roli i mësimdhënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga format e rrezikshme të punës".



Një aktivitet tjetër i rëndësishëm është zhvilluar nga anëtarët e Kuvendit të Arsimit Parauniversitar të Mitrovicës. Ata kanë marrë pjesë në trajnimin “Edukimi dhe menaxhimi mjedisor në Arsimin Parauniversitar ”. Në hapje të këtij aktiviteti kryetari i Kuvendit Isa Ismajli ka falënderuar SBASHK-un për gjithë angazhimet në shërbim të anëtarësisë dhe ka falënderuar trajnerin Agim Hasani për angazhimin dhe kontributin që ky aktivitet të ketë rrjedhë të mbarë.

Ai ka treguar se ky aktivitet po realizohet me pajtueshmërinë e plotë të gjithë pjesëmarrësve, që janë anëtarë të Kuvendit të Sindikatës së Arsimit Parauniversitar për Mitrovicën dhe se shpenzimet e qëndrimit këtu mbulohen nga buxheti i sindikatës komunale. Koordinatori për organizim të brendshëm Ymr Ymeri ka përgëzuar kolegun Isa dhe gjithë pjesëmarrësit për këtë aktivitet dhe duke përshëndetur në emër të SBASHK-ut trajnerin Hasani është shprehur i kënaqur me përkushtimin e pjesëmarrësve për rrjedhën e mbarë të këtij aktiviteti.

Koordinatori Ymeri ka shtuar se ky aktivitet dhe mënyra e organizimit të tij është shembull i mirë se si një Kuvend i Sindikatës së Arsimit Parauniversitar mjetet nga buxheti vetanak i dedikon për një aktivitet të qëlluar për ngritjen e vazhdueshme profesionale të anëtarëve të vet.